

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE KORCE

Nr. 3348 rep
Nr. 3043 kol



KONTRATE SHIT-BLERJE KUOTA KAPITALI

Sot me date 04.07.2017 (dymije e shtatembdhjete) ne zyren e noterise Korce ne Rrugen 28 Nentori, Perballe Deges se Tatim Taksave, para meje Bledar Zake, noter u paraqit personalisht:

PALËT:

1. **Daniel Lika** datlindja 01.02.1985 , madhor i afte per te kryer veprime juridike i identifikuar prej meje me ane te Kartes se identitetit nr 027245118 dhe nr te identitetit I50201037J (ketu e me poshte do te quhet SHITES nga njera ane) dhe
2. **Barjam Liçi** datlindja 18.03.1960, madhor i afte per te kryer veprime juridike i identifikuar prej meje me ane te Kartes se Identitetit me nr 032583162 me nr personal G00318088S, (ketu e me poshte do te quhet **BLERES**) nga ana tjetere.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME
BAZA LIGJORE

1.Kodit Civil i Rrepublikes se Shqiperise, Liqi Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", (i ndryshuar), Liqi nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" e legjislacioni i fushes ne fuqi.

Neni 1
Parashtesat

Meqenese ekzistojne keto kushte paraprake:

1.1 Meqenese palet kane rene dakort paraprakisht per transferimin e kuotave te kapitalit qe shitesi ka ne shoqerine « **START BUS KORCA** »shpk me NIPT K24722001V ne baze te pikes b neni 73 i Ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

1.2 Meqenese per transferimin e kuotave te kapitalit eshte dhene miratimi formal nga ana e asamblese se ortakeve te Shoqerise Shoqeria « **START BUS KORCA** » shpk shpk me vendimin date 27/06/2017.

1.3 Meqenese shoqeria « **START BUS KORCA** » shpk shpk eshte aktive ne organet tatimore dhe QKR, ne aktivitet te plote ekonomik dhe financiar, mbi kuotat e kapitalit te saj apo aksionereve te vecante nuk ka asnje ndalesa ligjore, pengese, inscriptim apo kufizim,
Palet kerkuan lidhjen e kesaj kontrate shitblerje kuotash kapitali me permbajtjen qe vijon.



Neni 2
Objekti i kontratës

2.1 SHITESI Daniel Lika, deklaron se është zoterues me 5.88% të kuotave të kapitalit ose 76.44 pjesë të zoteruara në shoqëria « **START BUS KORCA** » shpk të cilat ja shet bleresit **Barjam Liçi** që është plotësisht dakort për këtë.

Neni 3
Vlera e shitjes

3.1 Vlera e shitjes për 76.44 % pjesë të kuotave të kapitalit dhe i linjes së autobuzeve që ai ushtron aktivitet është me një vlerë 1.000.000 Lek (një milion Leke).

Neni 4
Menyra e pageses

4.1 Palet deklarojnë se Vlera totale e shitjes për kuotat e kapitalit që zoteron shitesi në kjo shoqëri është likujduar totalisht jashtë kësaj zyre nga bleresi.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Neni 5

1. **“SHITËSI”** garanton pronësinë e tij të plotë mbi kuotat e kapitalit objekt i kësaj kontrate shitjeje, si dhe garanton se ato janë të lira nga barra e çfarëdolloj natyre, vese, detyrime fiskale, të drejta apo pretendime të të tretëve, apo kufizime të tjera.
2. **“SHITËSI** deklaron se ka vënë në dispozicion të bleresit të gjithë informacionin përkatës për shoqërinë kuotat e të cilës janë objekt i kësaj kontrate shitblerje.
3. **SHITËSI“** detyrohen të lejojnë BLERESIN të gëzojë lirisht kuotat e kapitalit objekt i kësaj kontrate pa asnjë pengesë.
4. **PALET** deklarojnë se çdo lloj detyrimi tjetër është likujduar me përpara.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERESIT

Neni 6

1. **BLERESI** detyrohet të paguajë Shpenzimet për kalimin e kuotave të kapitalit objekt i kësaj kontrate, shpenzimet noteriale dhe të regjistrimit të Tij në QKR

Rregjistrimi në QKR

Neni 7

1. Palet u vënë në dijeni se këtë kontratë duhet ta regjistrojnë në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit në bazë të Nenit 43 të Ligjit nr 9753 datë 03.05.2007 “Për QKR”.

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Neni 8

1. Palët bien dakort që cdo mosmarrveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të kundërt Palët do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Korce.

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pala SHITËSE humbet te drejten e pronësise mbi kuotat e kapitalit ne kete shoqeri te drejte te cilen e fiton pala blerese mbas neneshkrimit te kesaj kontrate.
2. **Pikerisht Barjam Liçi i cili eshte ortak ne 76.31 pjese te zoteruara ne shoqeria STAR BUS KORCA mbas nenshkrimit te kesaj kontrate behet Ortak ne 152.75 Pjese te zoteruara ne Shoqerine START BUS KORCA shpk.**
3. Kesaj Kontrate i bashkengjiten 1 vendim i asamblese se ortakeve, 1 Ekstrakt Historik te QKR per shoqerine e dokumenta identifikimi.
4. Kjo kontratë shitblerje kutash kapitali hartohet ne kater kopje nga te cilat njera qendron ne noteri dhe dy te tjerat ju jepen paleve dhe tjetra dergohet ne QKR per ndryshimet perkatese.
5. Sa siper lexohet kjo kontrate shitblerje kuotash kapitali, palet ishin plotesisht dakort e nenshkruan pa verejtje para meje noteres.

PALET

SHITES

Daniell R. D.

BLERES

Barjam Liçi

NOTER
Bledar Zake



B